



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 207/9 prot.

Datë 09.02.2026

V E N D I M
Nr. 212/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.02.2026, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70411-11-26-2025, me objekt: **“Lot 1 “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme MM1”, me fond limit 18,696,979.17 (tetëmbëdhjetë milionë gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë shtatëmbëdhjetë) Lekë Pa TVSH ose 193,390.35 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë treqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e pesë) Euro PA TVSH**, zhvilluar me datë 29-12-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

BOE “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK me NIPT J61827062E & “MONTAL” SHPK me NIPT J62009007F dhe adresë Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 53, Ap 6b, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara
Rruga “Rreshit Çollaku”, Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK me NIPT L62217032L dhe adresë Tiranë, Rruga “Allaman Dervishi”, Pallati Classic A.M. Nr.31, Kthesa e Kamzës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar

I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27-11-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70411-11-26-2025, me objekt: **“Lot 1 “Blerje materiale mjekimi te përgjithshme MM1” me fond limit 18,696,979.17** (tetëmbëdhjetë milionë gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë shtatëmbëdhjetë) **Lekë Pa TVSH ose 193,390.35** (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë treqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e pesë) **Euro PA TVSH**, zhvilluar me datë 29-12-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 29-12-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 09.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Carpathia Albania” SHPK	14,100,000 lekë	skualifikuar
2. “Albadent Group” SHPK	15,666,007 lekë	kualifikuar
3. “Biometric Albania” SHPK	17,837,000 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 15.01.2026, në Sistemin e Prokurimit Elektronik autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 23.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 207/2026 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6272 e BOE “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK dhe “MONTAL” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70411-11-26-2025, me objekt: **“Lot 1 “Blerje materiale mjekimi te përgjithshme MM1” me fond limit 18,696,979.17** (tetëmbëdhjetë milionë gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë shtatëmbëdhjetë) **Lekë Pa TVSH ose 193,390.35** (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë treqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e pesë) **Euro PA TVSH**, zhvilluar me datë 29-12-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 207/1 prot., datë 26.01.2026.

II.7. Në datë 02.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar “Formulari i paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”,

dorëzuar nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, protokolluar pranë KPP-së me nr. 207/2 prot., datë 02.02.2026.

II.8. Me shkresën me nr. 3895/25 prot., datë 02.02.2026, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 207/3 prot., datë 03.02.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike aktin e trajtimit të ankesës së BOE “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK dhe “MONTAL” SHPK, vendim K.SH.A nr. 14/2026 nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.9 Me shkresën me nr. 3895/26 prot., datë 03.02.2026, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 207/4 prot., datë 05.02.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar aktin e trajtimit të ankesës së BOE “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK dhe “MONTAL” SHPK, vendim K.SH.A nr. 14/2026 nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.10. Me shkresën me datë 05.02.2026 me lëndë “Shkresë për shtim argumentesh në vijim të ankesës Nr. A/2026/6272, datë 23.01.2026”, protokolluar me tonën me nr. 207/5 prot., datë 05.02.2026 operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK ka dorëzuar argumente shtesë lidhur me vendimin e KSHA-së me nr. 14/2026.

II.11. Me shkresën me datë 05.02.2026 me lëndë “Shkresë për shtim argumentesh në vijim të ankesës Nr. A/2026/6272, datë 23.01.2026”, dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar protokolluar me tonën me nr. 207/6 prot., datë 06.02.2026 operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK ka dorëzuar argumente shtesë lidhur me vendimin e KSHA-së me nr. 14/2026.

II.12. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se janë paraqitur argumente nga subjekti i interesuar “Albadent Group” SHPK në përputhje me nenin 113 të ligjit “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK dhe “MONTAL” SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK me arsyetimin si vijon: “[...]Bazuar ne regjistrin kombetar te pajisjeve mjekesore te regjistruara ne Republiken e Shqiperise (perditesuar Dhjetor 2025), publikuar ne faqen zyrtare te Agjencise Kombetare te Barnave dhe Pajisjeve Mjekesore (AKBPM), <https://akbpm.gov.al/publikime/> , në përputhje me ligjin nr. 89, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”, operatori ekonomik Albadent Group ne pese vitet e fundit rezulton qe te kete regjistruar si pajisje mjekesore ne

Shqiperi vetem produkte konsumi te cilat i perkasin fushes dentare dhe ne asnje rast pajisje mjekesore per perdorim spitalor, sic jane edhe artikujt objekt prokurimi. Kujtojmë qe artikujt e kesaj procedure jane produkte mjekesore specifike dhe te rendesise se vecante klinike dhe jetike, te cilat perdoren ne salla operacioni, reanimacione, departamentet e urgjences etj. Keto produkte duhet te konsiderohen dhe vleresohen me pergjegjesi te larte. Fakti qe OE Albadent Group nuk ka regjistruar ne Shqiperi asnje pajisje te tille apo te ngjashme ne pese vitet e fundit (sipas ligjit nr. 89, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”) na jep te drejten per te shfaqur dyshimet tona te arsyeshme qe ky operator nuk e ploteson piken 2.3.1 te DST.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën nr. 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet si më poshtë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:**

- a)** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b)** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.2. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Lot 1 “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme MM1”

Nr	Artikulli	Specifikime	Njesia
	Garza, Bende, te tjera konsumable te pergjithshme		
1	Bende 7cm x 4 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
2	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë

3	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm2	Copë
4	Bende allcie 10cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë
5	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitese e mbrojtur me leter te shqiteshme	Copë
6	Bende allcie 15cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë
7	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
8	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensiononi i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako	Copë
9	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	m. linear
10	Fiksues kanjule	Fiksues kanjule / afersisht 8.5 cm x 6 cm / materiali , TNT adezive hipoalergjik /poliuretan dhe me garze perthithese ne mes, me kompresim te dyfishte .	Copë
11	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofël, pakete 100g	Copë
12	Leukoplast 5cm x 5m	cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	Copë
13	Vaj instrumentash	Vaj per mbrojtjen e endoskopeve dhe instrumentave kirurgjikale qe kane pjese te levizshme. Perdoret pas pastrimit dhe para procesit te sterilizimit. Shishe max. 50-100ml ose ekuivalent	Copë
14	Solucion pastrimi per optike	Per pastrimin e lenteve, siperfaqeve optike dhe fibrave optike te endoskopeve. Tubet 4-5 gram.	Copë
	Sisteme dhe doreza		
15	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP floë rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	Copë
16	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.	Copë
17	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	pale
18	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë
	Materiale konsumi per respirim, aspirim, infuzion		
19	Filter baktericid	per respirim artificial, antibakterial, HMEF	Copë
20	Qarqe respiratori	per respirim artificial L= 1.5 m; ID 22 mm	Copë
21	Absorbues CO2 per Anestezi	Permbajtja: Hidroxid Calciumi dhe Natriumi. Granulariteti 3÷5 mm. pH: 12 - 14. Ndryshim ngjyre pas saturimit me CO2.	Kg
22	Tuba Guedel	Nr. 00, 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8	Copë
23	Maske oksigjeni	me zgjatues L=1.5-2m	Copë
24	Sonde oksigjeni adult	nazale, adult, L=1.5-2 m	Copë
25	Sonde oksigjeni pediatrike	nazale, pediatrike L=1.6+0.6 m, diam .4 mm	Copë
26	Komplet aerosoli me tub zgjatues 1.5m	maske me rezervuar per medikamente	komplet

27	Set drenimi Redon me vakum ne forme fizarmonike 500-800ml Komplet redoni G 12-22	Set=(ballon vakumi+form z fold tub+dren+troakar)	set
28	Dren pleural	Tip trocar me brima anash	Copë
29	Dren silikoni	Ch 16-28, L=50cm, me vrima a neseore i detektueshem nga rrezet X	Copë
30	Dren Kehr	silikon, Ch 10-14-16-18-20	Copë
31	Tub drenimi	silikon, rulon 20-30m, diam. 6-8mm dhe 8-10mm	meter
32	Dren abdominal double drain me katere te brendshem		Copë
33	Maske per terapi CPAP	Madhesi e adoptueshme nga masa S deri ne L	Copë
34	Lageshtues per CPAP	Me tub konektor	Copë
35	Vaj silikoni	Per litotripsi ekstrakorporale; shishe 500ml	Copë
36	Solucion glicerine	Ne shiringe 10 ml, solucion uje steril 90% dhe glicerine 10%, per urologji.	Copë
37	Kateter venoz Seldinger 2-rruges	me dy rruge, tip Seldinger, L=20-30cm	Copë
38	Kateter arterial	20G-22G Seldinger	Copë
39	Urinokol pediatrik		Copë
40	Kapese kordoni umbilikal		Copë
41	Kateter umbilikal		Copë
42	Tub ushqimi pediatrik	Ch 4, 5. Pediatrik, neonatal. Pa latex/DEHP.	Copë
43	Zhgute		Copë
44	Tuba endotrakeale pediatrike	ID 2 - 5mm, nazal/oral	Copë
45	Tuba endotrakeale adult	ID 5.5mm-8.5mm, nazal/oral, me ballon	Copë
46	Kateter aspirimi pediatrik	Ch 8, 10	Copë
47	Kateter aspirimi adult	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë
48	Kateter me ballon per hemoragjine pas lindjes	Set steril per nderprerjen dhe menaxhimin e hemoragjise pas lindjes. Seti : Kateter silikoni Fr 24-25 me kanal per monitorim drenimi, ballon 500-600 mL, shiringe 50/60mL, set infuzioni, valvul 2-rrugeshe	set
49	Spekulum vaginal	Steril, nje perdorimesh.	Copë
50	Set punkcioni pleural	Set i perbere nga age veres, kateter drenimi 9-12Fr gjatesi 40÷50cm, qese drenimi min.2000ml, me valvul hyrese dhe shkarkimi.	Copë
Materiale konsumi per monitorim diagnostike			
51	Leter printeri ECHO		Copë
52	3-kanale		Copë
53	6-12 kanale		Copë
54	Xhel per ECHO	Bidone 5 kg , Xhel - Transonic / Transparent , densiteti - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë
55	Elektroda monitorimi EKG	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe	Copë
56	Aparat tensioni	Me manometer	Copë
57	Steto-fonendoskop	Koke e sheshte	Copë

58	Termometer	termometer pacienti	Copë
59	Spatula (druri)	Sterile, e paketuar individualisht	Copë
60	Set per identifikimin e nenes dhe femijes	Me dy pjese per doren e nenes dhe doren e femijes ne ngjyra te dallueshme	set
61	Gojez spirometrike		Copë
62	Set reanimimi neonatal	Sistem nje perdorimesh me manometer, per krijimin e presionit pozitiv ne salle te lindjes, per monitorim PEEP-PIP tek te porsalindurit premature.	Copë
63	Paste EEG / EMG	Adhesive ose Abrasive 250g	Copë
64	Elektrode rrethore EEG	Permbajtje Ag dhe kabell 90-100cm	Copë
65	Elektrode EEG tip ure	Elektrode ure per EEG	Copë
66	Sensor oksimetrie neonatal	Per monitor pacienti; set njeperdorimesh neonatal me sensor oksimetrie dhe kabllin perkates	Copë
67	Sensor oksimetrike	Per monitore pacienti. Shumeperdorimesh	Copë
68	Mansheta monitorimi TA	Per monitore pacienti. Shumeperdorimesh	Copë

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Albadent Group” ShPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

Faturë tatimore nr. 1669, datë 28.01.25;
Faturë tatimore nr. 23925, datë 01.12.25;
Faturë tatimore nr. 6841, datë 15.04.25;
Faturë tatimore nr. 23441, datë 24.11.25,
Faturë tatimore nr. 41214, datë 13.12.24;
Faturë tatimore nr. 38295, datë 04.12.24;
Faturë tatimore nr. 26537, datë 09.06.23;
Faturë tatimore nr. 28902, datë 20.07.23;
Faturë tatimore nr. 38295, datë 04.12.24;
Faturë tatimore nr. 670, datë 14.01.25;
Faturë tatimore nr. 22377, datë 29.03.23;
Faturë tatimore nr. 38100, datë 06.12.23;
Faturë tatimore nr. 18803, datë 31.01.23;
Faturë tatimore nr. 27110, datë 31.05.24;
Faturë tatimore nr. 26876, datë 15.06.23;
Faturë tatimore nr. 33074, datë 22.09.23;
Faturë tatimore nr. 26036, datë 31.05.23;
Faturë tatimore nr. 21276, datë 10.03.23;
Faturë tatimore nr. 1919, datë 30.01.25;
Faturë tatimore nr. 5914, datë 28.03.25;
Faturë tatimore nr. 1527/2023, datë 30.09.2023;
Faturë tatimore nr. 371815471/2023, datë 08.02.2023;
Faturë tatimore nr. 371818374/2023, datë 01.07.2023;
Faturë tatimore nr. 1033/2024, datë 20.02.2024;

Faturë tatimore nr. 7915/2024, datë 04.12.2024;
Faturë tatimore nr. 371815777/2023, datë 21.02.2023;
Faturë tatimore nr. 1424/2023, datë 26.09.2023;
Faturë tatimore nr. 2921/2023, datë 30.11.2023;
Faturë tatimore nr. 2301/2023, datë 01.11.2023;
Faturë tatimore nr. 2589/2023, datë 14.11.2023;
Faturë tatimore nr. 371816621/2023, datë 05.04.2023;
Faturë tatimore nr. 6698/2024, datë 24.09.2024;
Faturë tatimore nr. 220/2023, datë 02.08.2023;
Faturë tatimore nr. 294/2024, datë 15.01.2024;
Faturë tatimore nr. 7369/2024, datë 16.10.2024;
Faturë tatimore nr. 9291/2024, datë 19.12.2024;
Faturë tatimore nr. 17312, datë 08.01.24;
Faturë tatimore nr. 587, datë 13.01.25;
Faturë tatimore nr. 33671, datë 02.09.24;
Faturë tatimore nr. 40474, datë 04.12.24;
Faturë tatimore nr. 25912, datë 01.06.23;
Faturë tatimore nr. 33021, datë 21.09.23;
Faturë tatimore nr. 33086, datë 22.09.23;
Faturë tatimore nr. 31310, datë 24.08.23;
Faturë tatimore nr. 33096, datë 22.09.23;
Faturë tatimore nr. 20756, datë 01.03.23;
Faturë tatimore nr. 23126, datë 30.03.24;
Faturë tatimore nr. 42279, datë 30.12.24.

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar 32 kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”*

III.1.5. Neni 40, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: *“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” ShPK, në përmbushje të kriterit për furnizime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, nga krahasimi i specifikimeve teknike të mallrave objekt i këtyre faturave tatimore, të realizuara dhe të dorëzuara nga operatori ekonomik “Albadent Group” ShPK, me specifikimet teknike të produkteve objekt-prokurimi të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të

thelluar të specifikimeve dhe funksionit të mallrave objekt i faturave tatimore, dëshmime të furnizimeve të ngjashme të dorëzuar nga ana e këtij operatorit ekonomik parë kjo në rrafshin krahasimor me specifikimet teknike dhe funksionalitetin e mallrave objekt-prokurimi të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Kështu, referuar Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike” pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në listën e mallrave objekt-prokurimi autoriteti kontraktor ka parashikuar disa lloje produktesh dhe konkretisht si më poshtë: Garza, Bende, te tjera konsumable te pergjithshme, Bende 7cm x 4 m, Bende 10 cm x 10 m, Bende elastike 7.5cm x 4m, Bende allcie 10cm x 2.7m, Bende adesive 10 cm x 15 m, Bende allcie 15cm x 2.7m, Kompresse sterile 10cm x 10cm, Garze abdominale, Garze 91 cm x 100 m, Fiksues kanjule, Pambuk kirurgjikal, Leukoplast 5cm x 5m, Vaj instrumentash, Solucion pastrimi per optike, Sisteme dhe doreza, Sisteme infuzioni, Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit), Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit), Lama bisturie, Materiale konsumi per respirim, aspirim, infuzion, Filter baktericid, Qarqe respiratori, Absorbues CO2 per Anestezi, Tuba Guedel, Maske oksigjeni, Sonde oksigjeni adult, Sonde oksigjeni pediatrike, Komplet aerosoli me tub zgajties 1.5m, Set drenimi Redon me vakum ne forme fizarmonike 500-800ml Komplet redoni G 12-22, Dren pleural, Dren silikoni, Dren Kehr, Tub drenimi, Dren abdominal double drain me katere te brendshem, Maske per terapi CPAP, Lageshtues per CPAP, Vaj silikoni, Solucion glicerine, Kateter venoz Seldinger 2-rrugesh, Kateter arterial, Urinokol pediatrik, Kapese kordoni umbilikal, Kateter umbilikal, Tub ushqimi pediatrik, Zhgute, Tuba endotrakeale pediatrike, Tuba endotrakeale adult, Kateter aspirimi pediatrik, Kateter aspirimi adult, Kateter me ballon per hemoragjine pas lindjes, Spekulum vaginal, Set punkcioni pleural Materiale konsumi per monitorim diagnostike, Leter printeri ECHO, 3-kanale 6-12 kanale, Xhel per ECHO, Elektroda monitorimi EKG, Aparat tensioni, Steto-fonendoskop, Termometer Spatula (druri), Set per identifikimin e nenes dhe femijes, Gojez spirometrike, Set reanimimi neonatal, Paste EEG / EMG, Elektrode rrethore EEG, Elektrode EEG tip ure, Sensor oksimetrie neonatal, Sensor oksimetrike, Mansheta monitorimi TA. Në rastin konkret, KPP gjykon, se nuk kemi të bëjmë me materiale mjekimi të zakonshme, por me materiale mjekësore specifike ku evidenojmë ndër të tjera materiale konsumi per respirim, aspirim, infuzion, materiale konsumi per monitorim diagnostike. Në këtë mënyrë, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me furnizimin me produkteve me materiale mjekimi të përgjithshme, të cilat përdoren për shërbime shëndetësore specifike, ku evidentojmë katatere, tuba drenimi, sete reanimimi neonatal, punkcioni pleural.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të

gjykohej, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmive për furnizimet e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të furnizimeve të mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e dëshmive për furnizime të mëparshme ligjvënësi në nenin 40 pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e furnizimeve të ngjashme të realizuara me ente publike mund të përmbushet me paraqitjen e dëshmive të lëshuara nga ente publike për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme dhe në një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit në të cilën merr pjesë ofertuesi, ndërsa në rastin e furnizimeve të ngjashme të realizuara me subjekte private mund të përmbushet me paraqitjen e një ose disa faturave tatimore të shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi ku shënohen data, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ku vlera e tyre të jetë jo më e madhe se 40 % të vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit në të cilën merr pjesë ofertuesi. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në Vendim të Këshillit të Ministrave.

III.1.8. Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik ankimes “Albadent Group” SHPK, KPP konstaton se ofertuesi “Albadent Group” SHPK për plotësimin e kriterit kualifikues lidhur me furnizimet e ngjashme ka dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi fatura tatimore të shitjes të realizuara me subjekte private, të listuara në pikën III.1.3 të këtij vendimi, duke dëshmuar se ka kryer furnizimin me materiale mjekësore si në vijim: “Unit A5 Plus Continetal, Cefla SHS Sistem Hidrik, valvola për aspirim qendror, kompresor për 2 unite me secator 013230, aspirator cattani për 2 deri në 3 unite, tavolinë pune, karrele jolie con presa, silenz suppl turbo J-3 Tecno J, J2V Catt, sensore X-VS 20x30 mm ANTHOS, Rx DC wired Murale Cefla, RX DC wired Murale cefla, Grafi Dentare my ray, posdion rextar x grafi dentare, kompresor për 2 unite me secator, aspirator silenzios cattani, karrele jolie con pres, autoclave A-17 Anthos, ASA rolls 300x200 (roll plastifikimi), gutta percha 15 pearl dent, absorbent 15 pearl, spreaders 20 yelloë, hedstroem, K- files mani, tinerva mani 15 ëhite, doreza, major alginmax fruit-1x453g alginat, astek mouthëash tablets mint (pink), euronda kanjula blue, euronda kanjula transparent, turbines VRN-angel turbine, first examination kit (sonde hark), freza turbine shtraus, clearfill majesty esthetic, Gum sciss curved geshere te kthyera, Ex-3 Universal paste opaque UPNA, EX-3 Body A1B 50 gr noritake, katana zr yml, multichroma, eve teknik (goma xproteza)polystone, dental stone, dyll kuti, leter articulacioni, dezifektant, maska euronda, allci, bllok për përzierje cementi, termo froma eva soft transparent, olinano seal, pambuk dentar sumboë, shiringa 1cc lavash, speedex activator, shiringe diga defendo, alkool 1 l albadent, Thermo, villacryll, veshje uniti purple, UF Fixture SF (implant), submerged cemented abutment, aparate serumi me age, xhel per eko, kapse per kordon ombelikal, kompresa sterile, cotton, garza abdominale, gojez spirometrie, klorexidin, aqua oxigenata, formaldehyde,

benzalchonium chloride 10 %, clearfill majesty ES-2 A2, solvent per gutaperka, harvard, asa gum sciss curved geshare të kthyera, metal porcelan noritake, CZR Body A2B 10 g noritake, becht brush me pambuk, polishing buffers, age 1.3x21 mm biodent age denject, mixing boëls for plaster, knit park retraction cord, indurent gel, diadent 4 absorbent, bride laborator, major repair liquid, carbide cutter shape, devitec, pilpdent embrace wetbond varnish, stodont, bite boxgli, katalizator universal, goma lustrimi porcelani, spatula, rubber dam instrument kit asa, shapka ortopedike, xham për përzierje cementi, corape për tromboflebit. Referuar furnizimeve të kryera nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, Komisioni gjykon, se ky i fundit në asnjë rast nuk dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme dhe ka kryer furnizime të ngjashme me blerje materiale mjekimi të përgjithshme, e cila referuar specifikimeve teknike të mallrave objekt-prokurimi ndryshe nga materialet e paraqitura nga operatori ekonomik ankimes, në fokusin e saj ka si komponent kryesor materiale mjekimi të përgjithshme, ndërsa furnizimet e kryera nga operatori ekonomik janë furnizime të materialeve ortodontike për përdorim stomatologjik. Ndërsa referuar mallrave objekt prokurimi evidentohen materiale specifike mjekësore si, Sonde oksigjeni pediatrike, Komplet aerosoli me tub zgajtues 1.5m, Set drenimi Redon me vakum në formë fizarmonike 500-800ml Komplet redoni G 12-22, Dren pleural , Dren silikon , Dren Kehr , Tub drenimi, Dren abdominal double drain me katere të brendshme, Maske për terapi CPAP [..].

Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë furnizimi mallra, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimes janë furnizim me materiale dhe pajisje ortodontike, por në këto kontrata jo të gjithë mallrat e furnizuara janë të ngjashme lidhur me specifikimet dhe funksionalitetin e mallrave objekt-prokurimi për shkak të fushës sensitive që ato mbulojnë. Konkretisht referuar faturave të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimes Komisioni konstaton, se ato vërtetojnë furnizime me pajisje ortodontike që përdoren për trajtime specifike dentare, ndërsa materialet e përgjithshme të mjekimit objekt i procedurës së prokurimit janë të destinuara për një përdorim më të gjerë klinik në shërbimet shëndetësore. Këto materiale përdoren në procese diagnostifikuese dhe terapeutike në ambientet spitalore dhe nuk mund të konsiderohen të ngjashme me materialet ortodontike të cilat janë të destinuara ekskluzivisht për trajtime dentare dhe ortodontike. Produktet dentare janë të një natyre ambulatorie dhe kanë një përdorim të lokalizuar, lokalisht invazive, përdorim specifik dentar, ndërsa produktet mjekësore objekt prokurime (si katatere, tuba drenimi, aksesore EEG, ste reanimimi neonatal sete punkcioni pleural) përdoren për shërbime mjekësore specifike dhe më komplekse. KPP konstaton se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të specifikimeve teknike lidhur me natyrën e këtyre mallrave dhe funksionalitetit të tyre të pasqyruara në këto fatura, rezulton se vetëm fatura me nr.20756, datë 01.03.23 është e ngjashme për një pjesë të artikujve objekt prokurimi, vlera e së cilës sipas faturës tatimore, nuk arrin të përmbushi e vetme vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit në masën prej 40% të fondit limit. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të

suksesshme, pasi kontratat e paraqitura përmbajnë objekt dhe zëra të cilat nuk janë të ngjashëm me objektin e prokurimit, i cili si komponent kryesor të tij ka blerje materiale specifike për mjekim të përgjithshëm MM1. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori ekonomik “Albadent Group” ShPK duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga ky operator ekonomik, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontratat e mësipërme të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.1, të kapacitetit teknik.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik “Albadent Group” ShPK nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit, operatori ekonomik është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: “Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe

jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”; “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parimin: a) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”, KPP gjykon se operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK duhet të kishte dorëzuar kontrata të ngjashme sipas kërkesave dhe specifikave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.10. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementesh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë 38 nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga BOE ankimues “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK dhe “MONTAL” SHPK mbi kualifikimin e shoqërisë “Albadent Group” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar gjykimit më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të

Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK dhe “MONTAL” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70411-11-26-2025, me objekt: **“Lot 1 “Blerje materiale mjekimi te përgjithshme MM1” me fond limit 18,696,979.17 (tetëmbëdhjetë milionë gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë shtatëmbëdhjetë) Lekë Pa TVSH ose 193,390.35 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë treqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e pesë) Euro PA TVSH**, zhvilluar me datë 29-12-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK dhe “MONTAL” SHPK .
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

